

INSPEKTORATI SHITETOR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI MARS 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	09.03.2026	Kërkesë për t'u pajisur me vërtetimin që subjekti ka treguar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk kemi penalitete për shkelje të cilesive për vitin e fundit.	10.03.2026	Në lidhje me kërkesën për vërtetimin e kërkesave të standardit teknik të naftës dhe nënprodukteve të tyre e ardhur në adresën zyrtare elektronike të ISHTI-t, ju bëjme me dije se aplikimi bëhet online përmes platformës e-Albania.	E plotë	0
2	12.03.2026	Nëpërmjet këtij denoncimi kërkohet ndërhyrja dhe kryerja e një inspektimi të menjëhershëm në një subjekt e cila ushtron aktivitet në fushën e prodhimit dhe përpunimit të akulores. Në këtë subjekt ka evidente shkelje të shumta dhe të vazhdueshme të legjislacionit teknik dhe të standardeve të sigurisë që lidhen me përdorimin e makinerive dhe pajisjeve industriale. Këto shkelje përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e punonjësve, si dhe për sigurinë e aktivitetit industrial. Situata e përshkruar krijon një rrezik serioz për aksidente industriale dhe dëmtime të mundshme për punonjësit, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen e menjëhershme të autoriteteve përgjegjëse. Për sa më sipër, kërkohet kryerja e një inspektimi të plotë dhe të menjëhershëm në ambientet e këtij subjekti. Verifikimi i të gjithë dokumentacionit teknik dhe certifikimeve të makinerive dhe pajisjeve industriale. Kontrolli i instalimeve elektrike, sistemeve frigoriferike, pajisjeve nën presion dhe çdo pajisjeje tjetër industriale të përdorur në procesin e prodhimit. Marrja e masave administrative dhe ligjore në rast konstatimi të shkeljeve të legjislacionit teknik dhe të sigurisë industriale. Duke qenë se situata paraqet rrezik potencial për aksidente serioze dhe për cenimin e sigurisë së punonjësve, kërkohet që ky rast të trajtohet me prioritet dhe urgjencë nga strukturat inspektuese.	17.03.2026	Në përgjigje të ankesës tuaj të dërguar për të tretën herë, me email Nr.2668 Prot, datë 13.03.2026 ju bëjmë me dije se në inspektimin e fundit kryer nga inspektorët e ISHTI-t, në subjekt, u konstatua se ky subjekt për nevojat teknologjike kishte të instaluar pajisje nën presion, për të cilat dispononte të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor të pajisjeve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion".	E plotë	0
3	12.03.2026	Jemi duke bërë analizën e kostos për procedurën e zërit Karburant për përcaktimin e cimit të këtij zëri. Kërkojmë nga ana juaj densitetin e naftës dhe benzina për periudhën 14.02.2025-06.03.2025 si një nga elementet kryesore për llogaritjen e cimit të naftës dhe benzina.	12.03.2026	Në përgjigje të e-mail tuaj ju bëjmë me dije se nga analizimet e kryera në Drejtorinë e Laboratorit Qendror të ISHTI-t për periudhën 14.02.2025-06.03.2025 të produkteve gazol dhe benzine në procedurat e parazhdoganimit dhe kontrollit të tregut të brendshëm kanë rezultuar densitetet në 15°C si më poshtë: Gazoli nga 820.1 kg/m ³ deri në 841.9 kg/m ³ Benzine nga 721.1 kg/m ³ deri në 741.8 kg/m ³	E plotë	0
4	13.03.2026	Kerkoj qe te kryej analizat laboratorike per nje cope material saten te cilen mendojme ta perdorim per veshjet e administrates ne institucionin ku une punoj Per kete material kerkoj qe te kem te dhena per te cilat ju jeni akredituar nga DPA sipas nr.rendror 60 per tekstil te tilla si Përcaktimi i Trashësisë,Përcaktimi i dendësisë etj. Kerkoj nga ju te di sa duhet te jete madhesia e mostres qe duhet tju sjell psh 1/2 m apo 1m dhe cfare procedure duhet te ndjek per pagesen e	13.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se për mostren tekstile (saten) që jeni të interesuar të testoni pranë laboratorit tone duhet të ndiqni kete procedure: Duhet të dorëzoni pranë sekretarisë së ISHTI-t mostren që do të analizohet në permancen 1m në gjatësi. Mostra duhet të jetë e mbyllur në një zarf. Bashkangjitur duhet të dorëzohet edhe një kërkesë e firmosur nga institucioni ku të listohen edhe treguesit për të cilët jeni të interesuar që të analizohen. Në momentin e dorëzimit të kërkesës dhe mostres, do të informohen nga sekretaria e ISHTI-t mbi procedurën që duhet të ndiqet për pagesën e futares. Treguesit që ne jemi të akredituar për të analizuar janë: Përcaktimi i Trashësisë (EN ISO 5084:1996; S SH EN ISO 9073-2:2005) Përcaktimi i gjerësisë dhe i gjatësisë (SSH ISO 22198:2006) Përcaktimi i dendësisë (SSH ISO 7211- 2:1984) Përcaktimi i masës për njësi sipërfaqe (SSH ISO 3801:1977; ISO 29073- 1:2005) Përcaktimi i lagështisë (S SH ISO 17617:2014) Përcaktimi i qëndrueshmërisë së ngjyrës në larje (ISO 105- C10:2007) Përcaktimi i shprehshmërisë së ngjyrës në larje (ISO 105- C12:2014)	E plotë	0
5	17.03.2026	Kërkohet informacion lidhur me kryerjen e disa analizave laboratorike për detergjente. Parametrat për të cilët jemi të interesuar janë: Përcaktimi i densitetit Përmbytja e klorit Lagështia dhe lëndët volatile pH Tretshmëria Aftësia shkumuese Nëse është e mundur, ju lutemi që oferta juaj të përfshijë: Çmimin për secilën analizë Kohën e nevojshme për realizimin e testeve Çdo informacion shtesë të rëndësishëm për procedurën e analizave	18.03.2026	Lidhur me kërkesën tuaj ju bëjmë me dije se treguesit e paraqitur nga ana juaj për testim janë të realizueshëm në Laboratorin tone të akredituar. Çmimi për kampion (jo për tregues) është 9000 lek (te reja) dhe përshihen të gjithë treguesit që ju kërkon. Procedura që ndiqet është si më poshtë vijon: 1.Paraqiteni pranë ISHTI-t me një kërkesë dhe me kampionet që doni të analizoni tek protokollit 2. Personeli do t'ju pajisë me një mandat bankar që duhet të paguani në bankë dhe të sillni një kopje. 3. Afati kohor për analizimin është 5 dite pune për mund të realizohen dhe me shpejt në varesi të ngarkesës që mund të ketë në laborator. 4. Pdo përfundimit të të gjithë procedurës ju do njoftoheni për të marrë raport analizat për çdo produkt që keni sjelle.	E plotë	0
6	18.03.2026	Kërkohet informacion konfirmues, a jeni të akredituar për testimin e produkteve të mëposhtme: Solucion zbardhues higjienues(ACE) -Përcaktimi i PH -Tretshmëria në ujë -Përcaktimi i densitetit -Përcaktimi i klorit Sapun tualeti -Përcaktimi i PH -Tretshmëria në ujë -Përcaktimi i densitetit 3. Solucion për larje xhamash -Përcaktimi i PH -Tretshmëria në ujë -Përcaktimi i densitetit 4. detergjent larës pllakash dhe pajisjesh(Solucioin pllake) -Përcaktimi i PH -Tretshmëria në ujë -Përcaktimi i densitetit -Përcaktimi i përmbytjes së lëndëve tensioaktive Duke u nisur nga fakti që këto analiza kanë shumë rëndësi për një procedurë, kërkojmë nga ana e juaj një përgjigje zyrtare për konfirmimin, nëse laboratorit juaj është i akredituar për këto analiza .	18.03.2026	Ju konfirmojmë që të gjitha testet që ju kërkon për të analizuar janë tregues të akredituar dhe mund t'i realizoni pranë laboratorit tonë.	E plotë	0
7	18.03.2026	Kërkohet informacion lidhur me disa analiza, të cilat nuk i gjetëm të akredituara në listën tuaj. Konkretisht, bëhet fjalë për këto parametra: 1.Lënda e patretshme në etanol 2.Përmbytja e glicerolit 3.Alkaliniteti 4.Sulfatet 5.Viskoziteti 6.Përcaktimi i perboratit të natriumit 7.Alkaliniteti dhe aciditeti i lirë	18.03.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë se momentalisht nga treguesit që keni renditur realizojmë: Pika nr.6 përcaktimi i perboratit të natriumit i cili është tregues i akredituar. Pika nr. 1 lenda e patretshme në etanol (tregues i paakredituar) Pika nr.3 Alkaliniteti (tregues i paakredituar) Afati dhe kushtet janë të njëjtat si kundra ju kemi dërguar me e-mailin e mëparshëm.	E plotë	0